



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit
dhe Haxhi Shalës**

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 janar 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Urdhër për Parashtrime në lidhje me F00637

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit
Xhonatan Elistan Ris

Administratores
Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit
Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës
Tobi Kadman

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykses) lëshon këtë urdhër për parashtrime në lidhje me F00637.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 6 janar 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dorëzoi parashtrime për rishikimin e tetë të paraburgimit të Ismet Bahtijarit (z. Bahtijari), me të cilat kërkonte vijimin e paraburgimit.¹
2. Më 10 janar 2025, Mbrojtja e Ismet Bahtijarit (Mbrojtja e Bahtijarit) dorëzoi parashtrime për rishikimin e tetë të paraburgimit të z. Bahtijari dhe i kërkoi Trupit Gjykses të urdhëronte lirimin (me kusht) në Kosovë të z. Bahtijari, me pretendimin se nuk përmbushen më kriteret për vijimin e paraburgimit, sipas nenit 41(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji).²
3. Në të njëjtin parashtrim të protokolluar, Mbrojtja e Bahtijarit kërkonte lirimin (me kusht) të z. Bahtijari për arsye humanitare urgjente, përfshirë gjendjen shëndetësore akute dhe “jetëshkurtuese” dhe domosdoshmërinë për trajtim të përshtatshëm për këtë, sipas rregullës 56(1), (2), (3) dhe (5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja) (Kërkesa për Lirim për Arsye Humanitare).³

¹ KSC-BC-2023-10, F00636, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Ismet Bahtijarit* (Parashtrimet e ZPS-së mbi Paraburgimin), 6 janar 2025, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00637, Mbrojtja e Bahtijarit, *Parashtrime të Bahtijarit mbi Rishikimin e Paraburgimit dhe Kërkesë për Lirim për Arsye Humanitare* (Parashtrimet e Bahtijarit mbi Paraburgimin), 10 janar 2025, konfidenciale, para. 3 (f. 2), 3 (f. 7), 1-31 (f. 8-13), 62-64.

³ Parashtrimet e Bahtijarit mbi Paraburgimin, para. 4 (f. 2), 4-6 (f. 7-8), 32-59, 62-64.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Trupi Gjykues mbështetet në nenet 34(12) dhe 40(2) të Ligjit dhe në rregullat 9(5)(a), 23(2)(a), 76 dhe 116(4)(d) të Rregullores.

III. ANALIZA

5. Në fillim, Trupi Gjykues sqaron se konsideron që Kërkesa për Lirim për Arsye Humanitare, e përfshirë në Parashtrimet e Bahtijarit mbi Paraburgimin, përbën kërkesë më vete,⁴ që do të marrë përgjigje nga Trupi Gjykues me një vendim më vete.⁵

6. Trupi Gjykues vëren se do të kishte dashur që Mbrojtja e Bahtijarit ta kishte dorëzuar si parashtrim më vete Kërkesën për Lirim për Arsye Humanitare (e përfshirë në Parashtrimet e Bahtijarit mbi Paraburgimin),⁶ duke qenë se këto të dytat janë dorëzuar (saktë) nga Mbrojtja e Bahtijarit në përgjigje të Parashtrimeve të ZPS-së mbi Paraburgimin, në përputhje me afatet e vendosura nga Trupi Gjykues në *Vendimin mbi Rishikimin e Shtatë të Paraburgimit të Ismet Bahtijarit*.⁷ Meqenëse Kërkesa për Lirim për Arsye Humanitare është e pavarur nga Parashtrimet e ZPS-së mbi Paraburgimin, dhe afatet e lartpërmendura nuk do të lejonin hapësirë për parashtrime të mëtejshme, përpos një kundërpërgjigjeje të mundshme nga ana e ZPS-së ndaj Parashtrimeve të Bahtijarit mbi Paraburgimin në të cilat përfshihet Kërkesa për Lirim për Arsye Humanitare, Trupi Gjykues gjykon se është e përshtatshme të marrë parashtrime më

⁴ *Shih edhe* Parashtrimet e Bahtijarit mbi Paraburgimin, para. 7 (f. 8).

⁵ *Shih, ngjashëm*, KSC-BC-2020-04, Transkript i seancës, 19 tetor 2022, publik, f. 404, rreshti 18 deri f. 405, rreshti 17.

⁶ *Shih, ngjashëm*, KSC-BC-2023-10, F00433, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet Paraprake dhe Kërkesave të lidhura me To*, 12 gusht 2024, konfidencial. Një version i redaktuar publik u publikua po atë ditë, [F00433/RED](#), para. 46.

⁷ KSC-BC-2023-10, F00611, *Vendim mbi Rishikimin e Shtatë të Paraburgimit të Ismet Bahtijarit*, 26 nëntor 2024, konfidencial. Një version i redaktuar publik u publikua më 27 nëntor 2024, [F00611/RED](#), para. 34.

vete në lidhje me Kërkesën për Lirim për Arsye Humanitare dhe, rrjedhimisht, merr vendim të vendosë afate më vete për këtë qëllim.

7. Gjithashtu, me qenë se Mbrojtja e Bahtijarit bën parashtrime edhe në aspekt të kujdesit shëndetësor që z. Bahtijari është duke marrë në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (objekti i paraburgimit i DHS-së) në Kërkesën për Lirim për Arsye Humanitare,⁸ Trupi Gjykses gjykon se është e përshtatshme t'i kërkojë edhe Zyrës Administrative, si organi përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e objektit të paraburgimit të DHS-së sipas nenit 34(12) të Ligjit, të dorëzojë parashtrime mbi kërkesën në fjalë në bazë të rregullës 23(2)(a) të Rregullores.

8. Krahas kësaj, duke mbajtur parasysh nevojën për të marrë vendim të shpejtë mbi Kërkesën për Lirim për Arsye Humanitare, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme, sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, për t'i shkurtuar *proprio motu* afatet e parashikuara në rregullën 76 të Rregullores për përgjigjet dhe kundërpërgjigjet e mundshme.

IV. VENDIMI

9. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- (i) **UDHËZON** Zyrën Administrative të dorëzojë parashtrime (nëse ka) mbi Kërkesën për Lirim për Arsye Humanitare, në përputhje me paragrafin 7 të këtij urdhri, **jo më vonë se të premten, 17 janar 2025;**
- (ii) **UDHËZON** ZPS-në të dorëzojë përgjigjen e saj (nëse ka) ndaj Kërkesës për Lirim për Arsye Humanitare dhe ndaj parashtrimeve të Zyrës Administrative (nëse ka), **jo më vonë se të martën, 21 janar 2025;**

⁸ Parashtrimet e Bahtijarit mbi Paraburgimin, para. 46-47, 51, 62.

- (iii) **UDHËZON** Mbrojtjen e Bahtijarit të dorëzojë kundërpërgjigje ndaj parashtrimeve të Zyrës Administrative dhe/ose përgjigjes së ZPS-së (nëse ka), **jo më vonë se të enjten, 23 janar 2025**; dhe
- (iv) **UDHËZON** Zyrën Administrative, ZPS-në dhe Mbrojtjen e Bahtijarit ta informojnë me postë elektronike Trupin Gjykses në qoftë se nuk synojnë të dorëzojnë parashtrime, përgjigje ose kundërpërgjigje.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E mërkurë, 15 janar 2025

Hagë, Holandë.